



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT
Komisoni i Përhershëm i Infrastruktures

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: “Mbi miratimin e kërkesës për leje për vendosjen e shtatores së Nënë Terezës në bulevardin e qytetit”

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Propozimi mbështetet në Propozimi mbështetet në ligjin Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, bazuar në propozimin e Klubit Letraro Artistik “Në gjurmët e Dodonës”, propozojmë vendosjen e shtatores së Nënë Terezës në Parkun Qendror të Qytetit, pranë Bulevardit “Republika, me numër pasurie 11/03, Zona Kadastrale 8502.

Shtatorja do të realizohet nga skulptori Nezir Ago dhe do të financohet nga Klubi “Në gjurmët e Dodonës” si dashamirës të letërsisë dhe artit dhe mbi të gjitha të figurës së Nënë Terezës.

Situata aktuale e funksionit(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Figura e Nënë Terezës do të jetë 280 cm e lartë e realizuar në material bronx ku do të montohet në një pod 60/60/60 cm në mermer të bardhë. Figura është trajtuar sipas thënies së saj “Dita fillon me një buzëqeshje”.

Kjo nismë do jetë një vlerë e shtuar në identitetin kulturor të qytetit të Beratit dhe një homazh dinjitoz për një nga figurat më të ndritura të kombit tonë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Drejtoria / Sektori përgjegjës

Agjensia e Shërbimeve Publike Bashkia Berat.

Komisioni i Përhershëm për “ **Infrastrukturën**”, shqyrtoi projekt vendimin “Mbi miratimin e kërkesës për leje për vendosjen e shtatores së Nënë Terezës në bulevardin e qytetit” relacionin e dokumentat shoqërues,

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

- T'i propozojë Këshillit Bashkiak:
- Miratimin e kërkesës për leje për vendosjen e shtatores së Nënë Terezës në bulevardin e qytetit”

Komisioni i Infrastrukturës

Fadil Kallanxhiu

Albjon Sula

Llazarion Teneqexhiu